



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE KORCË

NOTER AFERDITA V. MOLLA
ADRESA NR.6, 6 DESHMORET, NR.1,
NR.1
TEL: 0694406798

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

Nr. repertori: 946

Korce më 28/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023033170038990175

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Studio Ligjore MENKSHIMarildaSH.P.K”

znj. Marilda Menkshi, **shtetase shqiptare**, me vullnet të plotë dhe në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, mbajtëse e Letërnjoftim me nr.037016240 , lindur në Korçë dhe me vullnet e zotësi juridike të plotë për të vepruar si edhe për krijimin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar; nëpërmjet këtij akti themelimi VENDOSI të themelojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar **“Studio Ligjore MENKSHIMarildaSHPK”**. Kjo Shoqëri, do të zhvillojë aktivitet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj, bashkëlidhur këtij akti si Aneksi 1. Ky Aneks 1, do të konsiderohet si pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

Neni 1

Emërtimi i shoqërisë

1.1 Shoqëria cilësohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, duke iu shtuar emrit të përzgjedhur edhe përcaktimi me SHPK. Emërtimi i saj specifik tregtar do të jetë **“Studio Ligjore MENKSHIMarildaSh.p.k”**, këtë e tutje do të përdoret në akt e njihet në të si **Shoqëria**.

1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj.

Neni 2

Selia

2.1 Selia e shoqërisë është në Korçë, në Lagjen 12, Rruga “ E veteraneve”, Shqipëri.

2.2 Shoqëria mund të hapë dhe/ose mbyllë zyra të tjera ndihmëse, apo seli për ushtrimin e aktivitetit të saj pjesor, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

3.1 **“Shoqëria”** do të ketë kohëzgjatje pacaktuar. Megjithatë në vizionin e ortakut të vetëm të saj parashihet dhe synohet një zhvillim veprimtarie të paktën 20 vjeçare në territorin e RSH.

3.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Ortakut të vetëm.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë të Shoqërisë

4.1 Shoqëria ka për objekt parësor të veprimtarisë dhe aktivitetit të saj, si më poshtë përmenden e listohen:

*V.O: Ky akt mban dhe rezervon garantimin e të drejtës të autorit sipas legjislacionit në fuqi ©Marilda Menkshi
Është në tre faqe sipas nomenclaturës së zakonshme me nga nje fletë të shkruar sejcila.
Ndalohet publikimi, apo përdorimi, jo sipas ligjit, i tij.*



- I. Shërbime juridike të fushave të ndryshme
- II. Këshillime juridike për zgjidhjen e problematikave në marrëdhënie të ndryshme juridike jashtëgjyqësisht.
- III. Shërbime këshillimi ligjor dhe social, në marrëdhëniet ndërpersonale me efekte juridike
- IV. Shërbime vlerësimi ekonomik, vlerësimi pasurish, apo të tjera aktevlërësuese dhe ekspertiza për inicimin e procedurave ligjore, në proces të rregullt ligjor dhe në vijueshmërinë e tij, me iniciativë.
- V. Zhvillim projektesh apo veprimtarish studimore në fushën e drejtësisë dhe në partneritet edhe me të tjera fusha studimore, me qëllim zhvillimin profesional dhe kualifikues të stafit të saj; përmirësimin e qënësisë dhe zhvillimit të jetës sociale-juridike në territorin ku zhvillon veprimtarinë.
- VI. Të ketë partneritet në veprimtaritë e saj me ndërveprues të tjerë, të pajisur me lejat, titujt apo licensat profesionale përkatëse.
- VII. Të koeporojë me Universitetet Shqiptare, Dhomën e Avokatisë të Shqipërisë dhe më gjerë për zhvillimin e veprimtarive të saj në fusha të veçanta zhvillimore të ekzistencës së saj dhe zhvillimit në përgjithësi të sistemit të Studiove Avokatore në RSH, Avokatëve dhe Juristëve në Republikën e Shqipërisë RSH.
- VIII. Të tjera në varësi të linjës bazë të shërbimeve dhe veprimtarive juridike.
- IX. **Shoqëria** mund të disponojë lirisht pronën e vet, asetet etj; duke kryer operacione të lejuara ligjore në raport edhe me institucionet financiare në RSH, me qëllim përmbushjen e objektit të **Shoqërisë**. Pra kushti i vetëm është që, këto aktivitete mos çënojnë qëllimin e ekzistencës së saj dhe këto aktivitete mos të vijnë në kundërshtim me objektin e veprimtarisë të shoqërisë.

4.2 Shoqëria për të realizuar objektin e saj mund të kryejë çdo lloj transaksioni lidhur me shitblerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qeraje apo hipotekimi, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj, me kusht, që aktivitetet mos të jenë në kundërshtim me Objektin e **Shoqërisë**.

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali i **Shoqërisë** është në vlerën 250000 dyqind e peswdhjetw mijw lekë dhe zotërohet nga ortaku i vetëm sipas ligjit.

Neni 6

Administrimi I Shoqërisë

Administratori i **Shoqërisë** është i tillë dhe i pajisur me kompetenca sipas ligjit edhe për të lidhur marrëdhënie ndërveprimi për interes të shoqërisë me të tjerë Avokate, ekspertë apo të tretë në përmbushje të Objektit të veprimtarisë të **Shoqërisë**.

Neni 7

2

*V.O: Ky akt mban dhe rezervon garantimin e të drejtës të autorit sipas legjislacionit në fuqi ©Marilda Menkshi
Është në tre faqe sipas nomenclaturës së zakonshme me nga nje fletë të shkruar sejcila.
Ndalohet publikimi, apo përdorimi, jo sipas ligjit, i tij.*



Veprime të ndaluara për Shoqërinë

Në raport me ndërvepruesit dhe të tretët për interes dhe në përputhje me Objektivin e Veprimtarisë të saj, Shoqëria nuk ka të drejtë që, pronat e paluajtshme të sajat, t'i konsiderojë kapital të transferueshëm në çdo lloj forme ndaj tyre me dhurim, apo forma të tjera të pakthyeshme të kalimit të pronësisë, përveç rastit të kredive bankare.

Neni 8

Të tjera parashikime mbi themelimin e Shoqërisë

Viti Financiar i Shoqërisë fillon më një (1) Janar të çdo viti dhe përfundon në tridhjet e një (31) dhjetor të çdo viti. Përgjatimisht, viti i parë financiar fillon në ditën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon në 31 Dhjetor 2023.


Neni 9

Për çështjet që nuk rregullohen nga ky Akt Themelimi vepron legjislacioni në fuqi.

Në përfundim të renditjes së neneve rregulluese të Këtij Akti Themelimi znj. Marilda Menkshi, themeluesja deklaron se ky Akt Themelimi dhe Aneksi 1 i tij, emërtuar "Statuti i Shoqërisë", është në përputhje me vullnetin e saj dhe për këtë arsye e nënshkruan sot më dt. 28 njëzet e tetë mars 2023 dy mijë e njëzet e tre, me vullnet të plotë e të lirë.

Themeluesja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Studio Ligjore MENKSHI Marilda SHPK"

Znj. Marilda Menkshi



(emër, mbiemër, nënshkrim, datë akti e shënuar me shkrim dorë nga nënshkruesja e aktit)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE KORÇË
NOTER AFERDITA V. MOLLA**



**DATE 28/03/2023
NR REP 946**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 28/03/2023, para meje Notere AFERDITA V. MOLLA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore KORÇË, me zyrë në adresën Korçe, NR.6, 6 DESHMORET, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Marilda Menkshi, atësia Sotir, amësia Natasha, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banues në KORÇË, me adresë Qemal Stafa 02330240; Nd. 4; H. 1; Korçë; Korçë; 7002; Korçë, lindur më 30/05/1983, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037016240 dhe nr. personal I35530044Q ,Personi i sipërpërmëndur vepron ne cilesine e ortakes se vetme të Shoqërisë tregëtare „**Studio Ligjore MENKSHI Marilda SHPK**” SHPK me qender ne qytetin e Korçës e cila t u shpreh ketu para meje noterit se nenshkrimi i vene ne Akt Themelimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar i Ortakut te vetem te Shoqerise „**Studio Ligjore MENKSHI Marilda SHPK**” SHPK eshte i saj e une noteri sikunder urdheron ligji i vertetoj neneshkrimin.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
AFERDITA V. MOLLA

